

*Intervistë për Epokën e Re, publikuar më, 26.02.2007*

*Ibrahim Makolli, zëvendëskryetar i Aleancës Kosova e Re*

*-Pse nuk u zgjedhët për postin e Ombudspersonit të Kosovës, ku ishin në të vërtetë problemet dhe a kishte dorë dikush të shprehemi kushtimisht që pengoi në zgjedhjen tuaj?*

Këtë pyetje ndoshta do duhej shtruar Kuvendit të Kosovës, ngase aty do të merrej përgjigja e merituar. Kjo tashmë i takon të kaluarës, për të cilën ndoshta as nuk e vlen të flitet, por megjithatë do ta them mendimin tim. Në të vërtetë, sikurse edhe dihet, në votimin e Kuvendit të Kosovës për postin e Avokatit të Popullit, unë jam zgjedhur në këtë post, në pajtim me procedurat ekzistuese, por që një pjesë e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, të pakënaqur me kandidatin e zgjedhur, shfaqën rezerva përkitazi me procedurat e miratuara nga ata vet dhe, kërkuan që kjo çështje të vendoset nga UNMIK-u, pra të kaloj përmes zyrës ligjore të UNMIK-ut, sipas tyre, për të bërë interpretimin ligjor. Kjo për mua dhe, besoj edhe për shumë të tjerë ka qenë e paarsyeshme, duke pas parasysh se Kuvendi vepron sipas procedurave të miratuara nga vetë Kuvendi dhe, të pranuar edhe nga UNMIK-u. Pra, ma thotë mendja se këtu nuk kemi pas të bëjmë me procedurat, por me kandidatin e zgjedhur. Le të mbetet në ndërgjegjen e vet atyre që i japin vetes të drejtë të luajnë me institucionin më të lartë në Kosovë. Sa i përket ndërhyrjes nga jashtë Kosovës në këtë çështje nuk do doja të komentoja asgjë, por kam informata të besueshme se ka pas këso ndërhyrjesh. Madje, që nga dita e parë kur është bërë publike kandidatura ime për këtë post, një personalitet jashtë Kosovës, konkretisht nga Serbia, ka filluar të shfaq nervozizmin e vet të padurueshëm dhe të kontaktojë edhe me personalitete të jetës publike e politike në Kosovë, duke u sugjeruar për t' mos më votuar mua. Madje, ka shkuar aq larg sa ia ka parë për të madhe edhe KMDLNJ-së pse më ka kandiduar mua për atë post. Kujtoj se deri diku ia ka arritur qëllimit që ta ketë ndikimin e vet për këtë gjë dhe si duket edhe më tutje po vazhdon avazi i vjetër, që në zgjedhjen e kuadrove në Kosovë të kenë ndikim, ata që edhe më parë kanë vendosur se cilat kuadro janë të përshtatshme e cilat jo.

*-A ishte mos zgjidhja e juaj për ombudsperson arsyeja që ju u larguat nga KMDLNJ dhe kaluat në Aleancën Kosova e Re?*

Jo. Absolutisht jo. Vendimi im për t'u larguar nga KMDLNJ, ku kam vepruar për gati 17 vjet me radhë dhe inkuadrimi im në një subjekt politik, më konkretisht në AKR, ka të bëjë thjesht me vendimin tim individual për t'u inkuadruar në rrjedhat politike në Kosovë. Unë kam pranuar kandidaturën e KMDLNJ-së për pozitën e Avokatit të Popullit ngase kam konsideruar se përvoja ime gati 17 vjeçare në fushën e të drejtave e të lirive të njeriut në Kosovë mund të jetë e çmueshme dhe me interes për të drejtuar Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë. Kam konsideruar se mund të jap kontribut në mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave e të lirive të njeriut në Kosovë, ngase përvoja që kam fituar në KMDLNJ, një organizatë shumë e njohur dhe e respektuar jo vetëm në Kosovë në fushën e të drejtave të njeriut, ma mundëson një gjë të tillë. Por, t'u them të drejtën pas lojërave në Kuvendin e Kosovës edhe e humba interesin për atë pozitë, duke gjukuar se cili do të jetë efekti i institucioneve të tilla, kur institucioni më i lartë në Kosovë, nga i cili zgjidhen dhe varen institucionet e tjera, nuk i respekton dhe nuk i zbaton procedurat e veta. Atëherë shtrohet pyetja se a na duhen dhe cili është efekti i institucioneve që janë produkt i një Kuvendi të tillë dhe në funksion të kujt mund të jenë ato si të tilla. As unë, e besoj as bashkëpunëtorët me të cilët në KMDLNJ jemi inkuadruar që nga vitet e 90-ta nuk e kemi menduar ndonjëherë se do të jemi një kohë kaq të gjatë në këtë organizatë. Periudha kur ne jemi angazhuar në KMDLNJ ka qenë krejt tjetër fare nga ajo që është sot dhe, konsideroj se edhe në këtë institucion ka nevojë për inkuadrim të njerëzve të rinj, të cilët mund ta japin kontributin e vet në mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të njeriut.

Më konkretisht, arsyeja pse unë kam vendosur që të kaloj në një subjekt politik, përkatësisht në AKR, është shumë e thjeshtë, por vendimi im që të largohem nga KMDLNJ ka qenë shumë i vështirë, të mos them vendimi më i rëndë në jetën time, ngase aty kam kaluar pjesën më të mirë

të jetës sime, të cilën nuk do ta ndërroja për asgjë në botë. Duke pas në vëmendje se shumë nga padrejtësitë që u bëhen qytetarëve, shkeljet e të drejtave dhe të lirive të njeriut ndodhin pikërisht për shkak të politikave të gabuara dhe, pamundësia që këto politika të ndryshohen nga jashtë, kam konsideruar se vetëm duke qenë pjesë e politik-bërjes mund të ndikoj në ndryshimin e politikave që derivojnë me shkelje të të drejtave të njeriut, prandaj edhe jam inkuadruar në jetën politike.

*Së pari*, ajo që më ka shtyrë të inkuadrohem në AKR është se ndaj idenë që Kosovës së re, i duhet në mendim i ri politik dhe një veprim i ri politik, që ky subjekt, më në krye z. Pacolli, i ka të gjitha parametrat për të këtë. Zoti Pacolli është njëri i veprave të mëdha e jo i fjalëve të mëdha dhe, Kosova tashmë ka nevojë për vepra e jo për fjalë.

*Së dyti*, përkushtimi i z. Pacolli, i çmuar si njëri shumë i suksesshëm në botën e biznesit, për mirëqenie të të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa dallim përkatësie etnike, fetare, moshore, gjinore, statusi ekonomik, etj. përkon pikërisht edhe me angazhimin tim të deritashëm në kuadër të KMDLNJ-së.

*Së treti*, konsideroj se vetëm ata të cilët nuk kanë nevojë të marrin nga Kosova kanë mundësi ta ndryshojnë gjendjen e tanishme të rëndë në Kosovë dhe, z. Pacolli është e vërtetë që nuk ka nevojë të marrë nga Kosova, ai për më tepër ka se çka i ofron Kosovës dhe qytetarëve të saj.

*Së fundi*, kujtoj se partitë ekzistuese nuk e kanë mundësinë për ndryshime çfarë i nevojiten shtetit të ri të Kosovës, pra nuk kanë mundësi ta luftojnë, në radhë të parë korrupsionin, ngase vet janë pjesë e tij, që tashmë është shndërruar në kancer për Kosovën dhe shoqërinë e saj.

Pra, këto kanë qenë disa nga arsytet pse unë kam vendosur që të inkuadrohem në jetën politike në Kosovë, konkretisht në AKR, që bashkërisht me stafin udhëheqës dhe me anëtarësinë e saj ta ndërtojmë një Kosovë, në të cilën të gjithë do ta ndiejnë veten të sigurt, të barabartë dhe të vlefshëm për veten dhe për shoqërinë. Kujtoj se për Kosovën duhet një vizion i ri dhe këtë vizion tashmë e ka AKR, të cilin do ta bëj realitet.

*-Çfarë dallon Aleanca Kosova e Re nga partitë tjera në Kosovë?*

Në të vërtetë, dallimet janë të mëdha, edhe pse në sipërfaqe mund të mos duken ato. Sikur e thash edhe më lartë, është koha që në Kosovë të ketë një mendim të ri politik dhe një veprim të ri politik dhe këto mund t'i ketë vetëm AKR, e cila nuk ka të kaluar politike. Dallimi thelbësor në mapot me partitë e tjera është pikërisht programi për zhvillim ekonomik, që parasheh kjo parti, duke pas parasysh gjendjen e rëndë ekonomike e sociale në Kosovë dhe domosdoshmërinë e tejkalimit të kësaj gjendjeje, e cila do të tejkalohet vetëm me program të qartë dhe me angazhim serioz. Kam bindjen se AKR, më në krye z. Pacolli do të jetë në gjendje që të bëjë përmirësim të kësaj gjendjeje, sidomos duke marrë në konsideratë suksesin që z. Pacolli ka arritur deri tash. Në asnjë rast nuk konsideroj se mund të ketë përmirësim nga ata të cilët e kanë sjellë në këtë gjendje Kosovën. AKR do të jetë në shërbim të qytetarëve të Kosovës dhe jo qytetarët në shërbim të saj. Ne, do të jemi shërbëtor të qytetarëve të Kosovës dhe, prandaj këtu konsideroj se ekziston një dallim shumë i madh mes AKR-së dhe subjekteve të tjera politike. Fryma e re, që AKR do ta sjellë në skenën politike kosovare, duke e pas qytetarin në qendër të vëmendjes është ajo që këtë subjekt do ta bëjë më të afërt me qytetarin. Koncepti i AKR-së dhe i z. Pacolli është koncepti për një Kosovë qytetare, ku njeriu vlerësohet jo në bazë të përkatësisë së tij, por në bazë të vlerave që ai ofron për shoqërinë. AKR është dhe do të jetë e hapur për të gjithë ata që angazhohen për ndërtimin e një Kosove të re, për të gjithë ata të cilët interesin e përgjithshëm e vënë në plan të parë dhe për të gjithë ata që veten e konsiderojnë shërbëtor të popullit. AKR do t'u ofrojë mundësinë të gjithë njerëzve kreativ që të japin kontributin e tyre për ndërtimin e një Kosove të re, në të cilën qytetarët e saj do të mund të jetojnë me dinjitet dhe të krenohen se janë shtetas të Kosovës. AKR do t'i hap dyert për të gjitha ato kuadro, sidomos të të rinjve, që nuk kanë gjetur hapësirë për të dhënë kontributin e tyre në të mirë të vendit dhe shoqërisë. AKR do të jetë parti e qytetarëve dhe jo parti e një grupacioni individësh për interesa të veta. Individët e tillë nuk do ta kenë vendin brenda radhëve të AKR-së. Motoja e AKR-së është luftë korrupsionit, luftë

papunësisë, luftë varfërisë dhe reforma në të gjitha fushat e jetës në Kosovë, duke i vënë në plan të parë sidomos fushat më të prekura, siç janë arsimi, shëndetësia, ndihma sociale, pensionet, etj.

*-Si i vlerësoni demonstratën e dhjetë shkurtit dhe reagimin e policisë?*

Nuk është e tepërt që të them se ajo që ka ndodhë më 10 shkurt është një tragjedi për Kosovën, e cila assesi nuk ka guxuar të ndodhë. Për fat të keq si pasojë të kësaj kemi dy viktima dhe dhjetëra të tjerë të plagosur e të lënduar. Një gjë duhet të jetë e qartë për të gjithë se e drejta e protestës është e drejtë e garantuar dhe askush nuk guxon të sanksionohet pse paraqet një mendim të kundërt me atë zyrtar. Për fat të keq në Kosovë një gjë e tillë nuk po kuptohet drejt dhe pasojat e këtij kuptimi jo të drejtë po derivojnë me tragjedi, sikurse kjo e 10-shkurtit. As sot, nuk e kam të qartë se si erdhi deri te kjo tragjedi, a ka mundur të evitohet ajo dhe a janë bërë përpjekjet për t'u evituar një gjë e tillë. Assesi nuk po mund ta kuptoj angazhimin e kontingjentit rumun të policisë së UNMIK-ut, kur dihet mirëfilli se pjesëtarë të këtij kontingjenti patën keqtrajtuar nënat e personave të zhdukur në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur në shtator të vitit 2005. Megjithatë, duhet të hulumtohen mirë arsyet e përdorimit të forcës nga ana e pjesëtarëve të policisë dhe fajtorët të përgjigjen konform me ligjin, sidomos kur kemi parasysh se në momentin e intervenimit shkalla e rrezikshmërisë nuk ka qenë e lartë, ndërkaq reagimi i policisë ka qenë shumë i dhunshëm dhe këtë krerët e policisë duhet ta pranojnë dhe të japin përgjegjësi. Nëse ndonjë nga protestuesit tejkalon limitet e një proteste paqësore nuk duhet të jetë pretekst i përdorimit të forcës së pakontrolluar ndaj të gjithë protestueseve, madje edhe ndaj kalimtarëve të rastit sikur ndodhi më 10 shkurt. Policia në radhë të parë duhet të jetë në mbrojtje të jetës së njerëzve, sepse jeta e njeriut është më e çmuar se gjithçka tjetër. Çdo dëm tjetër është i riparueshëm, ndërkaq shuarja e jetës së njeriut është e pariparueshme. Në Kosovë nuk guxon të cenohet mendimi i lirë, për më tepër duhet të ketë inkurajim për shfaqjen e mendimeve dhe të ideve edhe atëherë kur ato nuk i pëlqejnë ndokujt.

*-A janë të nevojshme demonstrata të tilla në kohën kur pritet zgjidhja e statusit?*

Në asnjë rast, pra as për shkak të momentit në të cilin gjendet vendi ynë, nuk duhet të jetë pretekst për të sanksionuar të drejtën e demonstratës. Arsyetimet se “nuk është momenti për protestë” janë të tejkaluara dhe të dëmshme. Gjithnjë do të ketë situata kur do të ndeshemi me momente të rënda në jetë, por megjithatë e drejta për të shprehur pakënaqësitë përmes formave të tilla, që janë të pranueshme në demokraci, nuk duhet cenuar në asnjë rast. Protestat paqësore nuk e dëmtojnë as tash zgjidhjen e statusit të Kosovës, këtë duhet ta dijë gjithsecili prej nesh. Për më tepër, kjo ju jap mundësi njerëzve që të paraqesin mendimet e veta, që edhe mund të mos jenë të pajtueshme me mendimin zyrtar për një çështje. Pra, nuk kujtoj se protestat e dëmtojnë zgjidhjen e statusit të Kosovës, natyrisht ato duhet të jenë brenda standardeve të njohura, ngase derivimi nga kjo, sjell një gjendje krejt tjetër. Unë jam i bindur që qytetarët e Kosovës nuk janë të interesuar të dëmtojnë përpjekjet edhe vendore e edhe ndërkombëtare për zgjidhjen e statusit të Kosovës, por gjithashtu kujtoj se qytetarët e Kosovës kanë të drejtë të jenë të njoftuar për të ardhmen e Kosovës. Privimi nga kjo e drejtë sjell edhe frustrime, edhe keqkuptime, edhe keqinterpretime e edhe mosbesim në procesin dhe në bartësit e tij. E ardhmja e Kosovës nuk është pronë as e një parlamenti, as e një qeverie, as e një ekipi negociator, as e një partitë politike, ajo është dhe duhet të jetë pronë e gjithë qytetarëve të saj, andaj edhe duhet të trajtohet si e tillë.

*-Si i shikoni konsultat në Vjenë dhe sipas jush, si do të mund të përfundojë procesi për zgjidhjen e statusit?*

Të gjithë ne, edhe përkundër deklarimeve se nuk do të ketë më takime e konsulta, besoj se kemi qenë të vetëdijshëm se një gjë e tillë do të ndodhë dhe, pikërisht ky është faji i Grupit të Unitetit, që jo gjithëherë ka qëndrime të qarta. Konsideroj se ka nevojë për konsulta, për të qartësuar shumë nga pikat e paqarta që përmban Pakoja e Ahtisait, por jam skeptik në atë se do të ketë ndryshime përmbajtjesore nga ajo që tashmë është kornizuar. Dallimet diametralisht të kundërta

mes Kosovës dhe Serbisë për të ardhmen e Kosovës nuk premtojnë ndonjë rezultat, andaj edhe konsultat në Vjenë i shoh më tepër nga prizmi i shterimit të mundësive të fundit për të ofruar pikëpamjet mes palëve.

Statusi i Kosovës nuk ka se si të përfundojë ndryshe përpos në pajtim me vullnetin e shumicës në Kosovë, pra shtet të pavarur dhe sovran. Këtu nuk ka dhe nuk duhet të ketë kalkulime nga askush. Kjo nuk është realizim i ëndrrës së shqiptarëve, sikur na bie ta dëgjojmë shpesh herë edhe nga politikanë vendorë, por kjo është e drejtë e patjetërsueshme e popullatës shumicë në Kosovë, të cilët janë mbajtur dhunshëm nën një juridiksion të një shteti që dhunshëm e ka okupuar Kosovën dekada më parë. Pavarësia e Kosovës nuk është dhe nuk duhet të jetë as rezultat i terrorit dhe masakrave që ka kryer regjimi i Millosheviqit, sikur na bie të dëgjojmë shumë herë, se Serbia e ka humbur të drejtën mbi Kosovën për shkak të politikës së gabuar të Millosheviqit, sepse një të drejtë të tillë Serbia nuk e ka pas asnjëherë mbi Kosovën dhe, prandaj nuk ka pas as se si ta humb një të drejtë e cila nuk ka ekzistuar kurrë. Serbia e ka okupuar dhe mbajtur dhunshëm Kosovën nën administrimin e saj për dekada me radhë dhe ky administrim tashmë është i përfunduar përgjithmonë. Pra, Kosova përfundimisht po kthehet në administrimin e qytetarëve të saj të cilët shekuj me radhë kanë derdhur gjak për këtë.

*-A ka rrezik nga vetoja ruse dhe a ka punuar në këtë drejtim Behxhet Pacolli si kryetar i AKR-së në evitimin e vetos?*

Është vështirë të jepet një konkludim i saktë për atë se cili do të jetë vendimi i Rusisë në Këshillin e Sigurimit, por ne besojmë se Rusia do të radhitet përkrah vendeve të tjera demokratike, për ta përmirësuar politikën e bërë gati 100 vjet më parë. Ne, besojmë, se më në fund edhe Rusia do të jetë e interesuar për stabilitet në rajonin e Ballkanit, stabilitet i cili varet kryekëput nga zgjidhja e statusit të Kosovës. Kujtoj që ka kaluar koha e aleancave për destabilitet dhe tashmë është koha e aleancave për stabilitet dhe ngritje të shkallës të sigurisë në nivel global, për çka besoj se është e interesuar edhe Rusia. Kryetari i AKR-së, z. Pacolli ka bërë dhe është duke bërë një punë të madhe në qarqet e politikës ruse për çështjen e Kosovës dhe ai, akoma është duke lobuar, jo vetëm në Rusi por edhe në vendet e tjera për pavarësinë e Kosovës. Angazhimi i z. Pacolli është i pakursyeshëm në këtë drejtim dhe, ne jemi të bindur se ky angazhim i tij do të japë rezultatet në momentin më vendimtar, jo vetëm për të tashmen por edhe për të ardhmen e Kosovës.

<#>